

04-84-PT (R. Haradinaj dhe të tjerë), aktakuza, 26.04.2006, 23, FDH-25702; OMPF, *Mbetjet...*, FDH-15297.

### Ramiz (Zenun) Tahiraj

(18.02.1945, shqiptar nga Hereçi/Ereç, komuna e Gjakovës/Đakovica, bujk, pesë fëmijë)

### Tushë (Arif Gjirkokaj) Tahiraj

(30.10.1949, shqiptare nga Hereçi/Ereç, komuna e Gjakovës/Đakovica, pesë fëmijë)

Në fillim të muajit gusht të vitit 1998, kanë filluar betejat mes forcave të UÇK-së dhe atyre serbe përreth fshatit të Hereçit/Ereç. Ishte kjo arsyeja që e detyroi Tushën me djalin Blerimin, të rejën e djalit të saj tjetër dhe mbesën të zhvendoseshin në Dujakë/Dujak. Ramizi ka mbetur me burra të tjerë në mbrojtje të fshatit. Në mbrëmje, ai iu bashkëngjiti familjes, ndërsa të nesërmen në mëngjes të gjithë së bashku u kaluan në Skivjan/Skivjane, ku i ka pranuar Halil Ademi. Në mëngjesin e ditës **6.09.1998**, nga ora 10:00, Ramizi me Tushën u nisën me makinën e tipit *Lada Riva* në vizitë te e bija në fshatin Skivjan/Skivjane. Nuk u kthyen më kurrë nga kjo rrugë. Të nesërmen, Blerimi me axhën Mustafën dhe një mik nga Irzniqi/Rznić u nisën për të kërkuar Ramizin dhe Tushën. Disa njerëz nga **Novosella e Re/Donje Novo Selo** u thanë se e kishin vërejtur makinën e Ramizit të kalonte nëpër fshat, përderisa banorët e Dujakës/Dujak, Jasiqit/Jasić dhe Gramaqelit/Gramočelj pohonin se atë ditë, për shkak të sulmeve të forcave serbe, asnjë veturë nuk ka kaluar nëpër fshatrat e tyre. Fati i Ramizit dhe i Tushes nuk ishte i njohur për familjarët për një kohë të gjatë. Në tetorin e vitit 2003, kufomat e tyre janë zbuluar në fshatin Piskotë/Piskot [Gjakovë/Đakovica], ku në muajin shtator të vitit 1998 ishin varrosur si të pidentifikuar në mesin e trupave që u nxorën nga **Liqeni i Radoniqit/Radonjičko jezero**. Familjarët i kanë marrë mbetjet mortore të Ramizit më 21.03.2005 dhe i kanë varrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në fshatin Hereç/Ereç. Mbetjet mortore të Tushes i kanë marrë më 20.12.2005. Po atë ditë, ajo u varros në varrezat e fshatit Hereç/Ereç.

**Burimet:** deklarata B.T, FDH-29208; OMPF, *Mbetjet...*, FDH-15297.

### Xhevdet (Shaban) Hoti

(1.07.1978, shqiptar nga Jabllanica/Jablanica, komuna e Gjakovës/Đakovica, pjesëtar i UÇK-së)

Xhevdeti aderoi në radhët e UÇK-së në fillim të muajit mars të vitit 1998. U paraqit në shtabin rajonal të UÇK-së në *Dushkajë/Dushkaja* pranë **Jabllanicës/Jablanica**. Në datën **8.09.1998**, Xhevdeti u nis për në shtëpi që të furnizohej me ushqim për pjesëtarë të UÇK-së. Kur hyri në oborrin e vet dhe duke kaluar pranë bunarit, u qëllua për vdekje nga një pushkë snajperi. Pas disa orësh, i ati dhe i vëllai e varrosën në pyll që gjendet përkajshkollës së fshatit. Pas përfundimit të luftës, mbetjet mortore të Xhevdetit janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Jabllanicë/Jablanica.

**Burimi:** H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

### Božo (Milutin) Džuver

(7.01.1976, malazet nga Podgorica, elektroteknik, pjesëtar i UJ-së)

Boža me prindërit Milutinin dhe Milijanan, vëllain Željkon dhe motrën Veren jetonin në Rrugën e *Proleterit*. Pas shkollës së mbaruar elektroteknike planifikonte të regjistrohej në studimet e letërsisë, por në fund të vitit 1997 shkoi në kryerjen e shërbimit të rregullt ushtarak, së pari në Novi Sad, ndërkaq më vonë në Bella Crkvë. Gjatë shërbimit ushtarak e ka kryer trajnimin për të drejtuar autoblindën e quajtur *Praga*. Në verë të vitit 1998, njësitit të Bozhës i ishte urdhëruar që të përgatitet dhe, gjatë të njëjtës natë, ajo u transferua në Kosovë. Në datën **8.09.1998**, ai me njësitin e tij rastisi të ishte në **Jabllanicë/Jablanica**. U ndalën për të drekuar. Në atë çast, një predhë ka rënë pranë Bozhës dhe e ka plagosur rëndë në stomak. Ka dhënë shpirt pas dy orësh. Familjarët e kanë varrosur atë në varrezat Zagoriq në Podgoricë [Mali i Zi].

**Burimet:** deklarata M.Dž, FDH-32478; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 74; USCG KGDH, *Registri...*, FDH-8817; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.